



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 93/13
Prishtinë, më 5.06.2013, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziri, Sevdije Lama dhe Duda Balje

Mungoi: Hykmete Bajrami.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Arbresha Kosumi (praktikante) Imba Rudaku (praktikante).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Besim Beqaj- Ministër i Financave, Agim Krasniqi Drejtor i Departamentit të Buxhetit në MF, Qerkin Berisha Drejtor i Departamentit Ligjor në MF, Bajram Rexhepi Ministër i Punëve të Brendshme, Ilhami Gashi Sekretar në MPB, Abdyl Ymeri Zëvendësministër i Drejtësisë, Ramadan Bytyqi dhe Baki Ginolli nga MD, Ymer Havolli Kryesues i FKPK-së, Ruzhdi Morina anëtar i Bordit të FKPK-së dhe Adrian Zalli Drejtor i FKPK-së, Mentor Shala Drejtor i Përgjithshëm në RTK, Adelina Vall dhe Mustafë Mustafa nga RTK. Rejhane Zylfijaj nga GIZ, moitorues nga Zyra e Presidentes.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit dt. 22.05.2013 dhe 24.05.2013;**
3. **Shqyrtimi i kërkesës për transferimin e mjeteve buxhetore nga Ministria e Punëve të Brendshme në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale me amendamentet e Komisionit Funksional për Legjislacion;**
5. **Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Legjislacion lidhur me Ligjin nr.04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor;**
6. **Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Legjislacion lidhur me Projektligjin nr.04/L-185 për tarifën e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë;**
7. **Shqyrtimi i Raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2012;**
8. **Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Radiotelezionit të Kosovës për vitin 2012;**
9. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e mbajtura e Komisionit, dt. 22.05.2013 dhe 24.05.2013

Kryetarja konstaton se procesverbalet miratohen pa vërejtje

3. Shqyrtimi i kërkesës për transferimin e mjeteve buxhetore nga Ministria e Punëve të Brendshme në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Kryetarja theksoi se Ministria e Punëve të Brendshme në bazë të pëlqimit me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe pas konslutimit me Ministrinë e Financave, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 13 të Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës, iu ka drejtuar me kërkesë Kuvendit të Kosovës për transferin e mjeteve buxhetore në shumë prej 1 milion euro dhe projektit kapital “ndertimi i shtëpive dhe rehabilitimi i objekteve banesore të personave të riatdhesuar” në Ministrinë e Mjedisit dhe planifikimit hapësinor në departamentin e banimit dhe ndertimit, në kategorin ekonomike investime kapitale

Bajram Rexhepi njoftoi se në pajtim me ligjin në fuqi kemi përfillur të gjitha procedurat dhe kemi bërë kërkesën për transferin e mjeteve në ministrinë kompetente, pasi që Ministria e Punëve të Brendshme në procesin e riadhesimit dhe riintegritetit e luan vetëm rolin e koordinatorit. Si rrjedhojë Ministria nuk merret me realizimin e projekteve të caktuara në këtë drejtim, është përgjegjësi e institucioneve tjera. Prandaj mejetet dhe projekti kapital gjatë fazës së përgaditjes së buxhetit kanë mbetur gabimisht në kuadër të buxhetit të MPB-së. Është një kërkesë e ngushtme pasi që kërkohet që projekti të realizohet sepse mund të ketë ndikim negativ në procesin e liberalizimit të vizave.

Kryetarja sqaroi se ligji për buxhetin thotë se për këtë qështje është kompetent të vendos Kuvendi dhe jo Komisioni.

Naser Osmani qështja e transfereve buxhetore është e rregulluar me Ligjin për menaxhimin e financave publike. Duke vlerësuar rëndësinë e kësaj qështje, mendojë që komisioni duhet përkrah një kërkesë të kështillë, për të cilën duhet të vendos Kuvendi në pajtim me procedurat ligjore në fuqi.

Sali Asllanaj mendojë që kërkesa është e arsyeshme dhe ministri ofrojë sqarimet bindëse, por të rekomanduar duhet shikuar edhe bazën ligjore, pasi që kemi të bëjmë me kërkesë për ndryshimin e ligjit të buxhetit, që është ligj sikurse ligjet tjera dhe duhet patur parasysh procedurat e ndryshim-plotësimit të ligjeve.

Kryetarja sqaroi se neni 13 paragrafi 5 i ligjit të buxhetit lejon një mundësi të tillë, që thotë se qdo transfer i mjeteve në mes organizatave buxhetore mund të bëhet vetëm me lejen paraprake të Kuvendit.

Xhevdet Neziraj theksoi se procedurat janë shumë të qarta dhe vlerësoj një qështje mjaftë urgjent ndërtimin e banimit për të riatdhesuarit. Përmendi rastet në Pejë që njerzit enden rrugëve për shkak të mos zggjdhjes së banimit dhe ky proces po ashtu vëzhgohet edhe nga shtetet që i kthejnë banorët. Prandaj është mirë që të decentralizohen mejetet janë edhe zyret për komunitete nëpër komuna që nuk kanë buxhet

dhe merren me qështjen e kthimit pa pasur mundësi në zgjidhjen e problemit. Është e rëndësishme të bëhet transferi dhe të kryhet shpejtë ndërtimi i këtij objekti.

Albana Fetoshi pyeti ku të bëhet ndërtimi i këtyre objekteve a do të ketë ende ndërtime të objekteve tjera të reja, a ka me pas destinim në një pjese të caktuar të territorit apo ka me pasur ndërtim sipas nevojë.

Ilhami Gashi në pyetjen e Xhevdetit, si Ministri kemi qenë në dy dilema, a me shku me rindërtim kolektive apo individuale? Sugjerimet e eksperteve ndërkombëtar kanë qenë që ndërtime individuale i siguron komuna, por nëse bëhen kolektive është më problem me i mirëmbajt objektet. Sa i përket decentralizimit ne jemi përpjek edhe ne vitin e kaluar që ta kalojm këtë fazë, por faza fillestare e këtij procesi është dashur me u konceptuar dikur dhe është vendosur në ministri, ne kemi formuar një kamp për dimër për akomodimin e njerzve, për ushqim dhe për kujdesje shëndetsore, integrimin e fëmijëve procesin mësimor, tani jemi në një fazë sepse i kemi nda zyret rajonale të komuniteteve, i kemi evidencën e saktë sa njerz edhe sa i kushton një komunë të përgadisim buxhetin edhe ta decentralizojn për vitin e ardhshëm

Bajram Rexhepi nuk është e paraparë për ndonjë regjion specifik po sipas nevojë.

Latif Gashi shihet se kemi të bëjmë me një gabim teknik, duke marr parasysh edhe interesin e përgjithshëm edhe standardet që i kemi për me i plotësuar, si komisioni ti rekomandojmë seancës plenare kështu që ketu i kemi përfaqësuesit e partive plotike, ti përgadisim edhe deputetë e tjer për natyrën edhe rëndësinë e këtij transfer të mjeteve.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë kërkesën për transferin e mjeteve prej 1,000,000.00 (një milion) euro dhe projektit kapital “Ndërtimi i Shtëpive dhe Rehabilitimi i Objekteve Banësore për Personat e Riatdhesuar”, nga Ministria e Punëve të Brendshme, nën-programi “Ri-integrimi i Personave të Riatdhesuar” - kategoria ekonomike shpenzime kapitale, në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nën-programi “Departamenti i Banimit dhe Ndërtimit”, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale me amendamentet e Komisionit Funkcional për Legjislacion

Kryetarja kemi të bëjmë me një projektligj që është vlerësuar me kosto shtesë buxhetore. Përveq kësaj janë disa nene që nuk janë të harmonizuara me ligjet në fuqi. Është fjala për nenin që rregullon qështjen e Njësive ekonomike në kuadër të shërbimit korrektues, sepse është shumë problem të lidhim organizmin dhe funksionimin e kësaj njësie me buxhetin e Kosovës. Në një paragraf thuhet se financohen nga buxheti i Kosovës, ndërkaq në një paragraf tjetër se akti i themelimit të tyre i trajton si shoqëritë tregtare. Janë dy qështje që nuk shkojnë së bashku dhe kemi nevojë për sqarime. Një qështje të përgjithshme që duha ta ngrisë është përmbajtja e deklaratave financiare që i bënë Ministria e Financave për projektligje që nuk janë të detalizuara sa duhe, më shumë fokusohen vetëm implikimi direkt në buxhetin e Kosovës, por jo edhe ndonjë analizë më të detajuar e dispozitave të projektligjit në fushën e financave. Deklaratat financiare të më hershme kanë qenë më mirë të përgaditura se këto të kohëve të fundit janë deklarata më shumë politike se sa profesionale, ndoshta ekziston arsyeshmëria për një gjë të tillë, por në komision na shkakton me tutje probleme.

Besim Beqa sa i përket qështjes në fjalë, Ministria e Financave ka shqyrtuar projektligjin dhe ka dhënë deklaratën financiare se projektligji ka kosto shtesë buxhetore dhe ka rekomanduar që ministria e drejtësisë duhet të zbatojë ligjin me buxhetin e lejuar për këtë vit dhe me parashikimet për tri vitet e ardhshme.

Kryetarja ne kemi nevoj për sqarime konkrete rreth qështjes së njësive ekonomike në kuadër të shërbimit korrektues dhe kemi nevoj për sqarimin e mundësisë së shtimit të numrit të të punësuarve në institucionet përkatëse në bazë të ligjit i cili është aprovuar dhe të cilat shpenzime nuk janë të parapara me buxhet edhe me KASH.

Agim Krasniqi Departamenti i Buxheti bënë vlerësimin e koston buxhetore të projektligjeve dhe shpreh opinionin me shkrim dhe këtu përfundon puna e këtij departamenti, se a do ta aprovoj qeveria edhe Kuvendi projektligjin që vlerësohet me kosto shtesë, është qështje e këtyre institucioneve. Sa i përket përmirësimit të kualitetit të deklaratave financiare kemi hartuar një dokument të ri që besojmë do të aplikohet muajin e ardhshëm dhe detyrimisht të gjitha organizatat buxhetore do të jenë të obligime me i paraqit të gjitha elementet të detalizuara që e bëjnë një kosto financiare.

Abdyl Ymeri arsyeja pse është kërkuar buxhet shtesë për punëtorë është sepse shërbimi sprovues është organ qendror shtetëror, në momentin kur në bazë të ligjit i ipet emri ka edhe organizimin e brendshëm sikur agjencionet e larta shtetërore. Duhet pas parasysh që në shërbimin sprovues nuk e kemi asnjë ekonomist i cili punon pasi që të gjitha punët janë përfunduar nga departamenti në kuadër të Ministrisë. Bartja apo kalimi i këtyre personave në shërbimin sprovues është e pamundshme. Ndërsa numri 10 i kërkuar nga shërbimi sprovues korrespondon me emërimin në bazë të ligjit. Çështja tjetër është tek rritja apo koeficienti i pozitës, nga të cilat kufizime mund të bëhen në shërbime dhe mallra në formë të reduktimit.

Kryetarja sqaroi se me rëndësi është mënyra e themelimit, mënyra e pagesës së njësive, tatimit është pakëz konfuze psh. me propozimin e Ministrit institucionet korrektuese themelohen me akt nënligjor të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Me këtë akt nënligjor përcaktohet lloji i tipit dhe selia e institucionit korrektues. Këtu mund të formohen më shumë institucione korrektuese. Citoj nenin 212. Lind pyetja se këto institucione a janë njësi publike ekonomike apo janë institucione private sepse nëse janë private si mund të financohen këto nga buxheti. Njësia ekonomike në të hyrat e realizuara nuk paguan tatim dhe detyrimet e tjera përveç tatimit në qarkullim.

Latif Gashi dua të dijë se kjo njësi ekonomike a do të krijoj buxhet në të ardhmen, pasi që unë besoj se kjo jo vetëm që do të krijoj buxhet por do të mbajë të gjithë të burgosurit. Sepse në asnjë shtet në botë përveç Kosovës i cili i paguan nga buxheti 800€ për një të burgosur. Nuk shoh asnjë problem pse mos të sigurohet buxheti kur të burgosurit ri socializohen me profesionin e mëhershëm.

Sali Asllanaj mendoj se është shumë logjike ideja e njësive ekonomike e cila vet do të gjeneroj të hyra për burgjet dhe të burgosurit por si të futet në korniza ligjore? Do të duhet të bëhet definimi i numrit të njësive, konsideroj që këto probleme financiare që janë me ligje të kenë një implikim financiar të arsyeshëm, i cili mund të mbulohet qoftë edhe nga zyrat e brendshme pasi që në kornizat afatmesme të shpenzimeve buxhetore nuk ekziston.

Abdyl Ymeri sqaroi se me të burgosurit merren dy shërbime: Shërbimi korrektues dhe ai sprovues që merret me dënime alternative prej një deri në tre vite. Me ligjin e ri këto dy shërbime bëhen organe të larta

qendrore në varësi të Ministrisë së Drejtësisë-ndryshe agjencione pothuajse të pavarura. Njësia ekonomike është në kuadër të shërbimit korrektues dhe është funksionale.

Naser Osmani kërkon sqarim: se a janë këto njësi juridike apo ekonomike?

Abdyl Ymeri janë njësi që merren ekskluzivisht me të burgosurit janë ekonomike dhe juridike, sepse në kuadër të këtij shërbimi korrektues është edhe njësia ekonomike.

Ramadan Bytyqi sqaroi se njësia ekonomike për fillim ka nevojë për mbështetje dhe një kapital themelues. Të ardhmen do të gjenerohen të ardhura. Shërbimi sprovues i është përshtat ligjit që ka ndryshu për gjykatat. Shumica e dijnë se në Ministrinë e Drejtësisë derisa ka qenë e rezervuar 99% të pozitave kanë qenë të Unmik-ut dhe kanë qenë menaxherat papërgjegjës. Mjekësia Ligjor dhe burgjet janë bart në 2010 në Ministri të Drejtësisë, kjo është arsyeja e pagave të ulëta. MD i ka shpenzuar të gjitha këto dhe përmes të kursimeve të brendshme i kemi mbuluar. Me zbatimin e ligjit do të shkarkohet shërbimi korrektues ku pritet të kete zvogëlim të numrit të shpenzimeve. Siq e dijmë është në ndërtim burgu i sigurisë së lartë dhe MD nuk ka kërkuar numër të stafit shtesë.

Latif Gashi konstatoj se pa i ditur problemet nuk mund të kemi ligj të mirë, prandaj ky ligj është i domosdoshëm dhe duhet të gjendet buxhet ose në kuadër të MF ose MD. Ska vend në botë që i mban njerëzit që janë në konflikt me ligjin. Nga 1800 të burgosur prej tyre mund të punojnë gjysma duke i siguruar të gjitha shpenzimet për vete. Në burg te Dubravës ka fabrika që janë jofunksionale, pasi që askush nuk i bënë funksionale.

Agim Krasiqi janë dy çështje, në kuptimin e ligjit qysh rregullohet pagesa e shërbyesve civil dhe çështja e dytë për shërbimin korrektues që realizon aktivitete ekonomike, duke krijuar kështu të hyra që hyjnë përmes një sistemi qendror, duke iu kthyer organizatës. Duhet sqaruar nëse mbetet statusi i këtyre njësive ekonomike siq është askush nuk e pengon shërbimin korrektues që të kryej aktivitete ekonomike. Nëse mendohet që këto njësi të kenë një status tjetër jashtë kësaj publike, kjo duhet të rregullohet me ligje të veçanta. Jemi pajtuar me FMN-në që nuk ka rritje të punëtorve dhe rritje të pagave me përjashtim të reformës së administratës publike. Së bashku me Ministrinë do të mundohemi ti gjejmë edhe këto 10 vende të punës, zakonisht kur bisedohet për çdo iniciativë të re veç vetëm me kërkesa shtesë. Nëse e shohim se në proces të buxhetit do të bëjmë përpjekje që edhe në sektorë të tjerë ti gjejmë këto vende.

Kryetarja konstatoj se çështja e punës së njerëzve në brendi të institucionit nuk është e rregulluar mirë me këtë ligj, regjistrohet sipas regjistrimit të shoqërive tregtare, ka statusin e personit juridik, ka aktivitetin ekonomik, të cilin e kryen përmes një llogarie të veçantë. Kjo llogari e veçantë duhet të përcaktohet përmes llogarisë e cila hapet në thesarin e MF-së ose në llogari të veçantë të një ndërmarrje prodhuese etj. Mendoj se duhet të formohet një grup punues, që do të punojë së bashku me Ministrinë e Financave dhe atë të Drejtësisë që të futet në sistem.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Përfundim

Caktohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale me amendamentet e Komisionit Funkcional për Legjislacion dhe hartimin e raportit me amendamente për Komisionin, në këtë përbërje: Naser Osmani (kryesues), Xhevdet Neziraj, Latif Gashi, Duda Balje, Sevdije Lama.

5. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Legjislacion lidhur me Ligjin nr.04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor

Kryetarja theksoj se kemi një rekomandim nga Komisioni për Legjislacion, por është shqetësuese çështja kur fillimisht është miratuar dhe nuk është shikuar dhe po të mos ndërhynte presidentja ky ligj do të kalonte. Rekomandimi i Komisionit për legjislacion thot se amendamenti i propozuar nga Komisioni për buxhet dhe financa nuk ka bazë juridike për procedim të mëtutjeshëm. Dua të iu njoftoj se çështja është ngritur sa i përket rekomandimeve të Komisionit për Legjislacion pasi që nuk jep rekomandime se çka duhet të veprohet mëtutje.

Latif Gashi sqaroj se kur janë miratuar rekomandimet në këtë ligj e kemi votuar të gjithë, poashtu kemi llogaritur se është në interes të përfituesve bizneseve, është në interes që të kaloj në procedura të shkurtra, mënyra sesi ka kërkuar Komisioni për Legjislacion është shumë e gjatë. Jam dakord respektimit të rekomandimeve të Komisionit për Legjislacion, dhe ne si Komision të rekomandojmë që gjithçka që duhet të lirohet le të fillojnë procedurat.

Kryetarja konstatoj se është rekomandimi i seancës që të harmonizohen komisionet dhe të dalim me një qëndrim.

Qerkin Berisha është analizuar edhe në vende të tjera sesi funksionon procedura e lirimeve doganore dhe kemi parë se shumica e tyre kanë dispozita të tilla që lejojnë procedura më të shkurtra, që Qeveria ti ndryshojë këto anekse. Propozimi do të jetë që të bëhet përmes Kuvendit pa e ndryshuar ligjin, pasi që rekomandimi i Komisionit për Legjislacion është ndryshimi i ligjit dhe nuk kemi qëndrim tjetër si Ministri.

Albana Fetoshi nëse ndryshohet aneksi s'mund të themi se nuk ndryshohet ligji, pasi që aneksi është pjesë e ligjit dhe qdo ndryshim apo plotësim duhet të bëhet në pajtim me procedurat e ndryshimit dhe plotësimit të ligjeve.

Qerkin Berisha theksoi se ligji nuk ndryshohet por ne vende të tjera demokratike Qeveria ka disa autorizime të cilat ia bartë Kuvendi Qeverisë që të ndryshohet ky aneks.

Xhevdet Neziraj theksoi se është e rëndësishme të harmonizohen qëndrimet me Komisionin për legjislacion para se të dilet në seancë se pastaj po bëhet problem.

Naser Osmani propozoi që ko qështje dhe pika pas kësaj të shtyhen në një takim tjetër, ndërsa Kryetarja dhe unë si zëvendëskryetar i parë të konsultohemi me kryetarin dhe zëvendëskryetarin e parë të komisionit për legjislacion për këtë qështje.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Përfundim

Shtyhet shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Legjislacion lidhur me Ligjin nr.04/L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor dhe i Projektligjit nr.04/L-185 për tarifën e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë, në një takim tjetër të komisionit.

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2012

Ymer Havolli njoftoi se raporti i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2012 korrespondon me 10 vjetorin e këtij Fondi dhe mund të themi se ky institucion së bashku me ndihmën e tjerëve ka arritur të kryej detyra e përcaktuara me ligj. Raporti është mjaftë i pasur me të dhëna për shtesë nga vitet e kaluara. Kontributet e arkëtuara këtë viti ishin 113 milion euro, kthim neto në investime 51 milion euro, pagesa të pensioneve kemi 8.7 milion euro Investime të reja 159 milion euro mjete pensionale nënë menaxhim 715 milion euro, llogari të kontributeve 418,000 dhe kontribues aktiv diku 266000. Shifet se gjatë vitit 2012 ka vazhduar politika e investimit të mjeteve dhe nga këto investimeve ka pasur një performancë pozitive prej 54 milion euro kthim neto të tyre. Ne morrem një rrezik të konsiderueshëm për një kthim të konsiderueshëm. Po ashtu Fondi ka investuar mjete edhe në fletobligacionet e qeverisë së Kosovës. Raporti përmban të dhëna për mjetet në menaxhim, për numrin e kontribuesve përfshirë edhe ata aktiv, të dhëna për kontributet e arkëtuara dhe të shpaguara si dhe të dhëna për kontribuuesit dhe për tërheqjen e kursimeve pensionale. Numri i kontribuesve po rritet kontribues për vitin 2012 ishin 3264, kurse vlera e mjeteve të shpërndara për kta përfitues 8.2 milion euro dhe fondi i kursimeve dalngadal po e merr një barrë nga Qeveria dhe po kujdeset për pensionistët e Kosovës. Para të gatshme janë afër 748 milion euro rritja është diku 152 milion euro krahasime me vitin e kaluar. Gjendja në tregjet financiar ka ndikuar dhe kthimit janë diku afër 180 milion kthim neto nga investimet që nga themelimi e derimë tash. Raporti iu është bashkangjitur edhe Raporti i Auditorit të Pavarur të Jashtëm lidhur me operacionet dhe mejetet pensionale të FKPK-së.

Latif Gashi Realisht kemi një raport të mirë të pregaditur konform ligjeve në fuqi dhe pas kësaj fjale profesionale dhe politike, kisha kërkuar me miratim për rekomandim në seancë.

Kryetarja shohim se është bërë ulja e numrit të kontribuesve pa adresë po prap se prap egziston një numër i madh i këtyre kontribuesve pa adresë është gjendja e këtyre kontributeteve deri më tani? Përkundër angazhimeve të Fondit për raportimin dhe alokimin e kontributeve, nga raporti shohim se kemi të bëjmë me shuma të larta të mjeteve të paalokuara. Si mendon Fondi të zgjidh këtë problem? Sa ka qenë e mundur që të rritet përqindja e investimit të mjeteve në blerjen e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe në përgjithësi në tregun e brendshëm? Qfarë masa ka ndërmarr Fondi rreth investimit të mjeteve në vendet që kanë shënuar ulje të rejtikut si psh. Italia, dhe plansimin e tyre në vendet me rejtik më të mirë, për të shmangur krizën dhe humbjen e mundshme të vlerës së mjeteve të investuara?

Ymer Havolli këto mjete të paalokuara janë duke u bartur nga viti në vit dhe fatbardhisht ky numër është duke u zvogëluar, fal bashkpunimit me ATK-në. Këto mjete janë mjete që kanë mbetur pa nominim, pra janë mjete që nuk i dihet kujt i përketin deri në momentin e pensionimit të tyre kur vin mi kërku dhe t'i ushëzojmë në kompanit e tyre me zëbërthy se është paguar në emrin e tyre. Fatkeqësia qëndron se kompani i ka bërë pagesen e kontributeve në mënyrë të grumbulluar se jo në mënyrë individuale dhe kjo do të paraqes probleme jo për Fondin e Kursimeve Pensionale po për ATK-në mi zëbërthy këto mjete për individ. Fatmirësisht ky numer është duke u zvogëluar dhe nuk po përsëritet më ky fenomen sepse po kontrollohen nga ne, ju dhe nga ATK-ja. Investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës ne kemi marr pjesë në të gjitha aukcionet që i kanë shpallur letrat me vlerë, mirëpo ne kemi një defekt në ligj sepse ne nuk jemi ofertuesi i parë me dhënë ofertën tonë, por ofertojmë përmes një ofertuesi sekondar i cili e din ofertën tonë dhe në fund po del me një ofertë më të ulët se edhe praktikisht ne jemi të bllokuar. Në tregun e brendshëm të paktën të jemi ofertuesi i parë dhe jo ofertuesi sekondar. Ne nuk po investojmë mjetet në vendet me rrezik të lartë, është bërë përparim edhe në përcjelljen ditore të qmimeve të aksioneve.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandoj Kuvendit të miratoj Raportin vjetor i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2012.

7. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012

Safete Hadegjonaj njoftoi se RTK ka përgaditur raportin sipas formularëve standard dhe janë prezantuar shpenzimet sipas kategorive ekonomike.

Mentor Shala njoftoj se raporti financiar i RTK-së është pasqyrë e punës që është bërë vitin e kaluar kur ka pasur një menaxhment tjetër.

Kryetarja Nga ajo që shohim në raport ka tejkalime të shpenzimeve , po në krahasim me vitet e kaluara ka një reduktim sa i përket shpenzimeve të mjeteve .Ne kemi pasur problem me borxhin e RTK-së që është bartur nga viti në vit dhe po shifet se kan fillaur ta zvoglojnë dhe duhet të gjejmë një mënyrë të kryhen edhe ato obligime që RTK-ja i ka me vite.

Latif Gashi shifet se raporti është dukshëm më i avansuar se sa raportet e mëparshme. Por shifet se kemi tejkalim të shpenzimeve, për Paga dhe Mëditje që është diku 10% , po ashtu ka një tejkalim për mallra dhe shërbime që është 3% ndërsa investimet kapitale janë të zvogluara në 84%, sugjeroj që të merren masa për zvogëlimin e deficitit dhe shpenzimeve për paga dhe mëditje dhe mallra dhe shërbime.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandoj Kuvendit të miratoj Raportin vjetor financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012.

8. Të ndryshme

8.1.Kryetarja njoftoi për takimin e realizuar me përfaqësus të Bankës Botërore dhe interesin e tyre për të pasur një takim të përbashkët me komisionin për tu njoftuar për mbështetjen e projekteve nga BB në Kosovë. Ata kanë shprehur gatishërinë që të takohen me anëtarët e Komisionit dhe të njoftojn për marrëveshjen që do të nënshkruajn me Qeverinë. Komisioni u pajtua që ti bëjë një ftesë Bankës Botërore për një takim të përbashkët për të biseduar për projektet e Bankës që do të realizojë në Kosovë.

8.2. Kryetarja njoftoi për pjesmarrjen e saj në takimin e realizuar në Mal të Zi në mes të Komisioneve për ekonomi dhe buxhet të ballkanit perendimor në kuadër të Rrjeti i Parlamenteve të Ballkanit Perëndimor

organizuar he financuar nga Westminster Foundation for Democracy, ku në takimet dy ditore është bisduar për politikat e konkurrencës të këtyre vendeve dhe për strukturën e organizimit dhe funksionimit të Rrjetit të ardhmen. Meqë ne jemi ftuar në dy takime, në cilësinë e vëzhguesit, kemi kërkuar që të bëhemi anëtar më të drejtat të plota në këtë mekanizëm rajonal, në të kundërtën nuk do të marrim pjesë më.

Mbledhja përfundoi: 13:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj